



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 856 Prot.

Durrës më 16.07.2020

VENDIM

Nr 12, datë 16.07.2020

**"PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR VËZHguesIT QË DO TË NDJEKIN PROCESIN ZGJEDHOR NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Durrës", neni 7 pika 8 i Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendim Senati Akademik nr.43, datë 11.02.2020, KIZ në mbledhjen e datës 16.07.2020,

VENDOSI:

1.KIZ vendosi të miratojë dokumentacionin për vëzhguesit që do të ndjekin procesin zgjedhor, si më poshtë:

- Dokument identifikues (*kartë identiteti/ pasaportë*) një fotokopje e të cilit do të ruhet në KIZ;
- Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për personelin akademik ose sekretariatë mësimore përkatëse për studentët, në të cilin të vërtetohet se është anëtar i trupës zgjedhore të universitetit.
- Kërkesa e kandidatit për autoritet drejtues, në të cilin autorizohet personi përfaqësues,

2.Përfaqësuesi i autorizuar nga kandidati dhe i akredituar nga KIZ ka të drejtë të vëzhgojë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve në të gjitha fazat deri në përfundim të procesit zgjedhor pranë të gjitha komisioneve ku ka interes të drejtëpërdrejtë kandidati.

3.KIZ miratoi gjithashtu modelin e kërkesës së kandidatit dhe modelin e autorizimit(bashkangjitur këtij vendimi) që do të lëshohet për vëzhguesin.


4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Indrit Bimi

Fatmira Prodani

Gentian Ruspi

KRYETAR  
Klodiana LEKA



Radovan Cela

Taulant Kullolli

Fisnik Qati